URDHËR
Nr. 157, datë 11.3.2021

PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 53, DATË 31.1.2020 "PËR NGRITJEN E KOMITETIT TË PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 33, germa "ë", të ligjit nr. 15, datë 10.3.2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020 "Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri", bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të urdhrit, bëhen zëvendësimet e anëtarëve si më poshtë vijon:

"f) Znj. Najada Çomo, zëvendësohet me znj. Ermira Kola, shefe e Shërbimit të Reanimacionit Pediatrik, QSUT;

g) Z. Tritan Kalo, zëvendësohet me z. Dhimitër Kraja, mjek infeksionist;

l) Znj. Narvina Sinani, zëvendësohet me znj. Jetmira Bebeci, drejtor AKBPM".

2. Në pikën 2 të urdhrit, pas germës "l" shtohet germa "ll" me këtë përmbajtje:

"ll) Z. Alban Ylli, shef i Sektorit të Sëmundjeve Kronike dhe Politikave të Shëndetit ISHP, anëtar".

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu